



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 51 prot.

Kamëz, më 25.6.2025

V E N D I M

Nr. 44.Datë 25.6 2025

MBI

“NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 69, DATË 14.06.2024 MBI, “KRIJIMIN E NDËRMARRJES SË GJELBËRIMIT, PARQEVE E REKREACIONIT” BASHKIA KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.06.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.39 Datë 20.06.2025 në mbështetje të nenit 13 të Kodit të Procedurave Administrative; nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 23, pika 9, nenit 33, pika 1, nenit 54, shkronja “d” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar: Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 119, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2025, 2026, 2027”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të pikës 1 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 69, datë 14.06.2024, “Mbi krijimin e Ndërmarrjes së Gjelbërimit, Parqeve e Rekreacionit, brenda territorit të Bashkisë Kamëz”, si vijon:

- Ishte: “Ndërmarrja e Gjelbërimit, Parqeve e Rekreacionit, brenda territorit të Bashkisë Kamëz”;
- Bëhet: “Ndërmarrja e Gjelbërimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike, Kamëz”.

2. Detyrat dhe funksionet e Ndërmarrjes së Gjelbërimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike, Kamëz do të jenë sipas përcaktimeve të bëra në aneksin bashkëlidhur këtij projekt-vendimi.

3. Numri i punonjësve të Ndërmarrjes së Gjelbërimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave, Kamëz do të jetë 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë).

4. Efektet financiare të këtij vendimi do të miratohen nga Buxheti i Bashkisë Kamëz, sipas zërit Gr.0, Kap. 5, Prog. 06260.

5. Për krijimin e strukturës së Ndërmarrjes së Gjelbërimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave, Kamëz ngarkohet Kryetari i Bashkisë Kamëz.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore si dhe Ndërmarrja e Gjelbërimit, Parqeve e Rekreacionit.

7. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI

